



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS – KANALIZIME
SHKODËR SH.A

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____. 2021

LËNDA: KTHIM PERGJIGJE

DREJTUAR: Znj.

PËR DIJENI : BASHKISË SHKODËR

Në përgjigje të kërkesës Tuaj datë 29.06.2021, drejtuar Bashkisë Shkodër dhe në zbatim ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Aktiviteti punues i vitit 2020 na përballi me sfida të shumta, të cilat padiskutim patën ndikimin e tyre në veprimtarinë ekonomike të Ujësjetë Kanalizime Shkodër (UKSH). Të ardhurat totale të gjeneruara nga aktiviteti kryesor furnizim me ujë të pijshëm dhe largim i ujërave të përdorura, për vitin 2020 kanë qënë 281 058 mijë lek pa TVSH, ndërsa arkëtimi i të ardhurave nga aktiviteti kryesor ka qënë 267 024 mijë lek.

Furnizimi me ujë i banorëve të bashkisë Shkodër realizohet me sistem të furnizimit nga pusët, me ngritje mekanike. I gjithë uji që furnizon sistemin e shpërndarjes duhet të pompohet nga pusët deri lart tek rezervuarët dhe direkt në rrjetin shpërndarës, gjë e cila bën që kostot e energjisë të jenë të konsiderueshme për UKSH, arsye kjo për të cilën në mbyllje të vitit 2020, UKSH rezulton debitore ndaj OSHEE në vlerën 269 508 mijë lek. Një pjesë e konsiderueshme e këtij borxhi është mbartuar nga ujësjetësi fshat, i cili iu bashkua ujësjetësit qytet në zbatim të VKM Nr. 63 Dt 27.01.2016.

Kjo gjendje financiare është e rrjedhojë e pamundësisë së shoqërisë për të gjeneruar të ardhura të nevojshme për mbulimin e shpenzime operative, për të garantuar furnizimin me ujë të banorëve të bashkisë Shkodër.

Infrastruktura e ujësjetësit dhe e kanalizimeve të ujërave të ndotura është shumë e amortizuar. Rreth 55% e rrjetit të ujësjetësit ka moshë mesatare më të madhe se 40 vjet, rreth 21% e tij ka moshë mesatare rreth 30 vjet dhe 24% ka moshë me të vogël se 20 vite, ku janë të përfshira të gjitha ndërhyrjet rehabilituese të realizuara gjatë viteve të fundit. Aftësia financiare e UKSH për të realizuar investime kapitale është e pamundur, prandaj UKSH me brigadat e saj të punës është e angazhuar maksimalisht në riparime dhe



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS – KANALIZIME
SHKODËR SH.A**

mirëmbajtje të rrjetit të saj, me qëllim garantimin e furnizimit me ujë të klientëve të saj brenda standardeve kombëtare të miratuara.

Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Shkodër, duke zhvilluar një aktivitet 24/24 e 7/7 me rëndësi jetike për banorët e Shkodrës ndeshet me vështirësi të shumta, ku mund të përmendim;

- Nivelin e ulët të të ardhurave, si rrjedhojë e tarifave të ulëta që aplikon, krahasuar me ujësjellësat e tjerë të Shqipërisë.
- Niveli i ulët i të ardhurave krijon vështirësi në mbulimin e shpenzimeve operative, të cilat si rrjedhojë e shkallës së lartë të amortizimit kanë nevojë për ndërhyrje të vazhdueshme për garantimin e ofrimit të shërbimit optimal për banorët e Shkodrës.
- Niveli i ulët i mbulimit me shërbim, sidomos për zonën rurale është një problem shumë i madh për UKSH. Pavarësisht pamundësisë për realizimin e investimeve me të ardhura të veta, UKSH ka bërë përpjekje maksimale duke hartuar projekte për përmirësimin e situatës së furnizimit me ujë të banorëve të bashkisë Shkodër, dhe ka kërkuar mbështetje financiare për financimin e tyre nga ana e qeverisë qendrore.
- Mos koherenca e legjislacionit që rregullon marrëdhënien në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet, krijon hapërisa të pambuluara ligjore të cilat krijojnë vështirësi në zgjidhje të plotë ligjore të kërkesave të ndryshme.

Mbështetja me fonde nga ana e qeverisë nuk ka qënë e mjaftueshme për UKSH. Në 3-mujorin e parë 2020 është akorduar një fond prej 7 200 mije lek për mbulim të shpenzimeve të energjisë elektrike, ndërkohë që detyrimi i prapambetur për energjinë elektrike i mbartur nga fshatrat është shumë më i lartë.

Rezultatet e arritura në kuadër të Reformës së ujit, ishin shpresë dhënëse, pasi një numër i konsiderueshëm i klientëve, u përfshinë në pagesën e detyrimeve të prapambetura dhe të tjerë legalizuan marrëdhënien e tyre me UKSH nëpërmjet hapjes së kontratave të ujit dhe instalimit të matësive. Gjithashtu janë realizuar edhe ndërprerje të furnizimit me ujë për të gjithë ata që nuk kanë realizuar formalizimin e marrëdhënies kontraktuale me UKSH gjatë fazës së mirëkuptimit. Nga fillimi i reformës së ujit janë hapur rreth 2000 kontrata të reja, janë instaluar rreth 2500 matësia ujit, si dhe janë lidhur mbi 2000 akt-marrëveshje për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Forma ligjore aktuale e shoqërisë UKSH është SH.A (Shoqëri aksionere), nga eksperiencia e krijuar nga zbatimi i reformës së vitit 2016, ku u realizua bashkimi i ujësjellësit qytet me ujësjellësit fshat, mund të themi të bindur se në rast të ndiqet e njëjta mënyrë nuk mundet të funksionojë ideja e krijimit të një shoqërie ujësjellës të vetme.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS – KANALIZIME
SHKODËR SH.A**

Shoqëria e re e krijuar nga bashkimi i ujësjellësit qytet dhe fshat rezultoi në një shoqëri me detyrime të mbartura të energjisë elektrike, problemet themelore të të cilave nuk u zgjidhën, por thjesht u bënë bashkë, gjë që e shtoi më tej listën e problemeve me të cilat duhet të përballet UKSH.

Gjatë 5-vjeçarit të fundit janë bërë përpjekje maksimale për përmirësimin e treguesve të UKSH dhe performanca e mirë e viteve të fundit, ka bërë të mundur që UKSH të arrijë të nënshkruajë një marrëveshje financimi me KFW, për ndërtimin e ITUN (impiantit e trajtimit të ujërave të ndotura) për qytetin e Shkodrës, si dhe rehabilitim të rrjetit të furnizimit për lagjet periferike të qytetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

ADMINISTRATORI

Mark MOLLA